

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 11
26.03.2015

NR. VENDIMI 8
30.03.2015

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, e përbërë prej:

Ardit MUSTAJ - GJYQTAR

Asistuar prej sekretares Olta Sinanaj, sot me dt.30.03.2015, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën e paraqitur prej:

KËRKUES: **Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë**, përfaqësuar nga prokurori Gentian Trenova.

OBJEKTI:

1. Sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme me numër pasurie xxx, zona kadastrale xxx dhe regjistër hipotekor me nr.xxx, datë xxx, me pronar shtetasin Q.A.T., me 100% të pjesës zotëruese, që ndodhet në qytetin e xxx, që është një ndërtesë me x kate (x kat lokal dhe x kate banesë), x katet e para me sipërfaqe xxx m² dhe x katet e tjera me sipërfaqe xxx m², me sipërfaqe totale xxx m², si dhe të të gjitha objekteve të luajtshme dhe pajisjeve që ndodhen në ndërtesën në fjalë dhe që janë pjesë funksionale e ndërtesës.
2. Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohen Zyrat e Përmbarimit xxx, ndërsa për administrimin dhe përdorimin e pasurive që do të sekuestrohen, E.B. dhe K.Xh., administratorë në Agjensinë për Administrimin e

Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë
Ministrisë së Financave Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 3-7, 11, 12, 14, 15 e vijues të ligjit nr.10192, dt.3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Gjykata, pasi shqyrtoi aktet dhe dëgjoji prokurorin që kërkoi pranimin e kërkesës;

V Ë R E N S E:

Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë ka filluar procedimin pasuror nr.x, dt.xxxx, sipas ligjit nr.10192, dt.3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (në vijim ligji nr.10192/2009).

Ky procedim ka filluar mbi bazën e shkresës nr.xxx prot., dt.xxxx të Prokurorisë së Përgjithshme, e cila i ka dërguar Prokurorisë për Krime të Rënda aktet e ekstradimit në shtetin italian të shtetasit shqiptar Q.T., ndaj të cilit Gjykata e xxx (Zyra e Gjyqtarit për Hetimet Paraprake), me vendimin nr.xxx xxx xxx, datë xxx, ka caktuar masën e sigurimit “arrest në burg” pasi dyshohet për kryerjen e veprës penale të trafikimit të lëndëve narkotike (për fakte penale të ndodhura në vitin 2012), sipas nenit 110 të K.Penal italian dhe 73 të DPR 309/90, e cila në K.Penal shqiptar i korrespondon veprës penale të “Trafikimit të narkotikëve” të parashikuar nga neni 283/a.

Po kështu, policia gjyqësore, me iniciativën e saj, pas marrjes së informacionit nga Zyra e Interpolit në xxxx për masën e mësipërme të sigurimit ndaj shtetasit Q.T. (për të cilën ai u arrestua nga policia gjyqësore me dt.xxx dhe më pas Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxx caktoi ndaj tij, për qëllimet e ekstradimit, masën e sigurimit “arrest në burg”, sipas neneve 493 e vijues të K.Pr.Penale), ka kryer hetimin pasuror në drejtim të tij dhe me dt.xxx, ka përpiluar informacionin/referimin për fillimin e procedimit pasuror, i cili, së bashku me të gjitha të dhënat e mbledhura, iu dërgua Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë me shkresën përcjellëse nr.xxx, dt.xxx, të Drejtorisë së Policisë së Qarkut xxx.

Mbi këto akte Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë ka regjistruar me dt.xxx, procedimin pasuror ndaj shtetasit shqiptar Q.T. dhe ka paraqitur në gjykatë kërkesën objekt gjykimi.

Nga të dhënat e mbledhura nga policia gjyqësore (siç u përmend më lart), ka rezultuar se në emër të shtetasit Q.T. figuron e regjistruar në Zyrën e

Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme xxx, sipas shkresës së kësaj të fundit nr.xxx prot., dt.xxx, një ndërtesë me x kate (x kat lokal + x kate banesë), me sipërfaqe xxx m², ndodhur në qytetin e xxx, zona kadastrale xxx, regjistruar me numër pasurie xxx, vol.xxx, fq.xxx, regjistër hipotekor nr.xxx, dt.xxx, me truall në pronësi të shtetit. Leja e ndërtimit është dhënë me dt.xxx. Sipas aktit të kolaudimit, rezulton se koha e realizimit të punimeve ka qenë 13 muaj, punimet kanë përfunduar me dt.xxx dhe vlera e shpenzimeve të kryera është xxx (xxx) lekë.

Me anë të kërkesës objekt gjykimi, Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, në bazë të neneve 3/1/ç dhe 11 të ligjit nr.10192/2009, kërkon që të vendoset nga gjykata sekuestrimi i pasurisë së paluajtshme në emër të shtetasit Q.T., përfshirë edhe sendet e luajtshme që ndodhen brenda saj në funksion të ndërtesës. Sipas prokurorisë, pasuria e mësipërme është ndërtuar nga personi i dyshuar Q.T. në periudhën e veprimtarisë së dyshuar kriminale në Itali dhe se nga hetimi pasuror provohet se ky i fundit dhe familjarët e tij nuk kanë të ardhura të cilat mund të justifikojnë këtë pasuri, sipas të dhënave të marra nga organet përkatëse, dhe se, nga ana tjetër, ekziston rreziku i tjetërsimit të saj dhe i pamundësisë së zbatimit të masave të këtij ligji. Bashkëngjitur kërkesës nga prokuroria janë paraqitur edhe aktet dhe provat që vertetojnë rrethanat e mësipërme.

Gjykata, çmon se kërkesa e prokurorisë për sekuestrimin e pasurisë duhet pranuar, pasi plotësohen kriteret e kërkuara nga nenet 3 dhe 11 të ligjit nr.10192/2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Neni 11/1 i ligjit nr.10192/2009 në të cilin bazohet kërkesa e prokurorit, konkretisht parashikon:

“1. Me kërkesë të motivuar të prokurorit, gjykata vendos sekuestrimin e pasurive të personave, sipas nenit 3 të këtij ligji, kur ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie që tregojnë se personi mund të jetë i përfshirë në veprimtari kriminale dhe zotëron pasuri apo të ardhura, që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre dhe kur:

a) ekziston një rrezik real për humbje, marrje apo tjetërsim të fondeve, pasurive apo të drejtave të tjera, mbi të cilat parashikohet vënia në zbatim të masës së konfiskimit, sipas dispozitave të këtij ligji; ose

b) ka dyshime të arsyeshme që tregojnë se zotërimi i pasurive dhe ushtrimi i veprimtarive të caktuara ekonomike, tregtare dhe profesionale janë në gjendje rreziku apo ndikimi nga ana e një organizate kriminale ose që mund të lehtësojnë veprimtaritë kriminale.

...”

Pra, për vendosur sekuestrimit e pasurive nevojitet që personi të jetë i dyshuar për të paktën një nga veprat penale të parashikuara në nenin 3/1 të ligjit dhe se pasuritë apo të ardhurat që zotëron ai ose personat e lidhur me të (sipas nenit 3/2 të ligjit) të mos i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara, dhe as nuk justifikohen prej tyre. Krahas këtyre, nevojitet që të ekzistojë edhe një nga rastet e parashikuara në gërmat “a” dhe “b” të nenit 11/1 të ligjit.

Shtetasi Q.T. rezulton se është subjekt i zbatimit të ligjit nr.10192/2009, pasi, siç parashikohet në nenin 3/1/ç të ligjit, në ngarkim të tij ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie, për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/a i K.Penal. Madje, në rastin konkret, dyshimi arsyeshëm mbështetet më shumë sesa vetëm në indicie, pasi gjykata italiane ka caktuar edhe masë sigurimi ndaj tij për këtë vepër penale dhe në vendimin e saj ajo ka analizuar dyshimin e arsyeshëm të mbështetur në prova kur ka caktuar masën e sigurimit.

Sipas nenit 3/4 të ligjit nr.10192/2009, ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e personave, të krijuara përpara hyrjes në fuqi të tij, me kusht që pasuritë të jenë vënë gjatë përfshirjes së dyshuar të personit në veprimtarinë kriminale, sipas këtij ligji. Pasuria e mësipërme rezulton se është krijuar në vitet xxx-xxx, madje më së shumti në vitet xxx-xxx, e cila përkon me periudhën e përfshirjes së dyshuar në aktivitetin kriminal, që sipas vendimit të gjykatës italiane është viti xxx.

Në rastin në gjykim, prokuroria dhe policia gjyqësore kanë kryer verifikime në lidhje me aktivitetet ekonomike dhe të ardhurat e mundshme të realizuara nga subjekti Q.T. dhe familjarët e tij dhe rezulton se shtetasi Q.T. gjatë periudhës në fjalë ka kryer veprimtari ekonomike si person fizik, pasi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me NIPT xxx. Po kështu, sipas shkresës nr.xxx prot., dt.xxx të Degës Doganore xxx, rezulton se ai ka kryer veprimtari importi mallrash të ndryshme në periudhën Nëntor xxx - Nëntor xxx (rreth 9 herë). Më pas nga prokuroria janë kërkuar të dhëna edhe nga organet tatimore (me shkresat e saj nr.xxx prot., dt.xxx drejtuar Drejtorisë së Përegjithshme të Tatimeve dhe nr.xxx prot, dt.xxx drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore xxx) dhe ka rezultuar se shtetasi Q.T. ushtron aktivitetin privat “*Bar-kafe. Tregti mallrash të ndryshme. Eksport import mallrash të ndryshëm*” si person fizik, i regjistruar pranë QKR (siç u përmend më lart) me dt.xxx. Në mënyrë të veçantë, nga Drejtoria Rajonale Tatimore xxx me shkresën nr.xxx prot. dt.xxx janë dërguar edhe ekstrakte nga të dhënat për pagesat dhe deklaratimet e kryera nga subjekti Q.T., ku përfshihen edhe “Ekstrakti i pagesave të sigurimeve shoqërore dhe tatimit të thjeshtuar të fitimit të vitit xxx” dhe “Ekstrakti i situatës financiare sipas viteve”, të cilat konstatohet lehtësisht se përmbajnë shifra dhe vlera dhjetra herë më të vogla

sesa vlera e deklaruar e shpenzimeve për ndërtesën e mësipërme (xxx lekë). Pra, nga këto të dhëna bazë nuk rezulton në këtë gjykim që vlera pasurisë të justifikohet me të ardhura të ligjshme nga subjekti Q.T.

Nga ana tjetër, gjykata vlerëson se në lidhje me pasuritë e mësipërme potencialisht ekziston në çdo kohë rreziku i tjetërsimit dhe i shkaktimit të pamundësisë për të zbatuar masat parandaluese të parashikuara në këtë ligj, pasi kalimi i pronësisë apo tjetërsimi i ndërtesës bëhet nëpërmjet kryerjes së veprimit juridik përkatës dhe regjistrimit të tij në ZRPP, pa qenë e nevojshme edhe dorëzimi i saj. Për pasojë, me arrestimin për llogari të kërkesës për ekstradim në shtetin italian dhe me ardhjen e mundshme në dijeni për hetimin pasuror, në çdo kohë është i mundur tjetërsimi i këtyre pasurive nga subjekti Q.T, qoftë edhe nëpërmjet një prokure të posaçme të lëshuar për këtë qëllim. Prandaj, ekziston rreziku real i tjetërsimit të pasurive dhe për rrjedhojë gjykata vlerëson se përmbushet edhe kërkesa e nenit 11/1 gërma “a” e ligjit nr.10192/2009.

Gjykata sqaron se masa parandaluese e sekuestros sipas ligjit nr.10192/2009, është masë me karakter të përkohshëm, me afate të përcaktuara në ligj, që lidhet patjetër me ekzistencën e një hetimi pasuror të filluar dhe ka si qëllim ruajtjen e pasurive të të gjitha llojeve nga humbja apo tjetërsimi dhe, në të njëjtën kohë, heqjen e mundësisë së përdorimit të mëtejshëm të tyre në veprimtaritë kriminale. Kjo masë është në funksion të realizimit të qëllimit kryesor të hetimit pasuror që zhvillohet sipas këtij ligji, atij të konfiskimit të pasurisë kur vertetohen kushtet e parashikuara në këtë ligj.

Gjithashtu, gjykata sqaron se megjithëse gjykimi i kërkesës për sekuestrim sipas ligjit nr.10192/2009 bëhet vetëm me pjesmarrjen e prokurorit (neni 12/1), shtetasi Q.T. që preket nga masa parandaluese duhet të njoftohet nga gjykata për vendimin e dhënë në mungesë të tij dhe ka të drejtën e ankimit në gjykatën e apelit (nenet 14/2 dhe 27/1).

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 3, 5, 7, 11, 12, 14, 15, 26, 27 të ligjit nr.10192, dt.3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe neneve 126, 306 e vijues të K.Pr.Civile,

V E N D O S I :

1. Sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme ndërtesë me x kate (x kat lokal + x kate banesë), me sipërfaqe xxx m², ndodhur në qytetin e xxx, zona kadastrale xxx, me numër pasurie xxx, vol.xxx, fq.xxx, regjistër hipotekor nr.xxx, dt.xxx, e regjistruar pranë ZRPP xxx në emër të shtetasit Q.T., si dhe të sendeve të luajtshme dhe pajisjeve që

ndodhen në ndërtesën e mësipërme dhe që janë pjesë funksionale e saj.

2. Administratorë të pasurive të sekuestruara caktohen E.B. dhe K.Xh., administratorë pranë Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

3. Për ekzekutimin e masës së sekuestros ngarkohet Zyra e Përmbarimit Gjyqësor xxx.

4. Ky vendim t'i njoftohet nga sekretaria e gjykatës shtetasit Q.T. sipas rregullave procedurale civile.

5. Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, brenda 15 ditëve, ku ky afat për palën në mungesë (shtetasin Q.T.) fillon nga njoftimi i tij.

Tiranë, më 30.03.2015.

**SEKRETARE
OLTA SINANAJ**

**GJYQTAR
ARDIT MUSTAJ**